



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:010455
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05473611

P.nr./..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarit V..M.. për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 2242/2021 të datës 19.01.2022, pas mbajtës së seancës se shqyrtimit fillestar hapur për publikun me datë 14.02.2024 në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të pandehuri V..M., të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht ndërsa me datë 01.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V..M., i lindur me datë, në fsh. N... K. R., tani me banim në fsh. V.. R.. I.. K. P., nga babai R.. dhe nëna S.. e gjinisë G.., ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomik, i martuar baba i dy fëmijëve, i njohur me numër personal, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në ndalim policor për 48 orë dhe atë nga data 09.08.2021, ora 16:10, mbrohet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

PËR SHKAK SE:

Me datën 09.08.2021, rreth orës 20:10 min në fsh. V.. K. P..pikërisht në lokalin që gjendet ne të njëjtin kompleks ku gjendet Stacionin Policor në V.. dhe zyra e vendit, pa autorizim dhe për herë të parë ka poseduar substanca narkotike të llojit “marihuan”, në atë mënyrë zyrtaret policor pasi kishin shkuar në kafën e ngjitur në stacionin policor për të ju përgjigjur një rrahje që kishte ndodhur në mes të disa personave, në vendin e lartcekur pas legjitimitit dhe kontrollit në trup tek i pandehuri V.. në xhepin e djathtë kanë gjetur një sasi të vogël narkotiku të cilën ia konfiskojnë, ku pas ekzaminimit të substancë narkotike sipas pajisjes *NarTest NTX2000* rezulton se është e llojit marihuanë, me peshë neto rreth 0.7 gram,

- me çka ka kryer vepër penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 lidhur me par.1 te KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të nenit 7, 17, 38, 39, 43, 69, 70, 71 dhe 269 të KPRK-së, 7, 8 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurit të pandehurit V..M.. i shqipton:

DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200,00 € (dyqind) euro, ne të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar ne ndalim policor nga data 09.08.2021 deri me 11.08.2024 9 48 orë), e të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 1 (një) muaji, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguajnë dënimin e mbetur me gjobë ne shumë prej 180,00 (njëqind e tetëdhjetë euro) brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro

I pandehuri obligohen që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 40 € (dyzet) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuan, në peshë prej 0.7 gram.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 19.01.2022 ka ngritur aktakuzën PP / II nr. 2242/2021 të datës ndaj të akuzuarit V..M.. për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës 13.02.2024 gjykata në pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar te pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pasi i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e leximit të aktakuzës gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzat dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë. I pandehuri është deklaruar: : e pranoj fajësinë për veprën penale sipas aktakuzës, jam penduar dhe shton se është e vërtetë që e kam kryer këtë veprë dhe premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla

Në vlerësimin e pranimin të fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit e cila ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet ne këto prova siç janë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2021-DA-1401 i dt. 09.08.2021, raporti i analizës se narkotikeve i dt. 09.09.2021, raporti i policit S.. A.. #7172 i dt. 09.08.2021, vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dt. 09.08.2021, fotografi, raportet mjekësore të lëshuara nga Spitali Rajonal K. P.. për të lënduarin V..M.. dt. 09.08.2021, deklarata e të pandehurit O.. Z.. e dhënë në Stacionin Policor ne P.. me dt. 09.08.2021, deklarata e të pandehurit B. Z.. e dhënë në Stacionin Policor ne Pejë dt.09.08.2021, deklarata e të pandehurit V..M.. e dhënë në Stacionin Policor ne P.. me dt. 11.08.2021, deklarata e dëshmitarit I.. S. e dhënë në Stacionin Policor ne Pejë me dt. 09.08.2021, deklarata e të pandehurit D.. S.. e dhënë ne Stacionin Policor P.. me dt. 11.08.2021, lista e dëshmive dt. 09.08.2021, ekspertiza mjeko ligjore e dt. 21.12.2021, si dhe të bëhet shikimi në shkresat e lëndës, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze të së cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 269 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, është i martuar, baba i dy fëmijëve, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprave penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitat te këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet për paushall gjyqësor në shumë prej 20,00 €, e duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj dhe 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit,

Konform nenit 269 par.3 të KPRK-së gjykata të akuzuarit i ka konfiskuar substancën narkotike e llojit marihuan, në peshë prej 0,7 gram.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2022:010455, 19.03.2024**

Bashkëpunëtorja profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate